

Rregullorja e Zgjedhjeve për Qeverinë Studentore të Shkollave të Lartë për Vitin Akademik 2004 - 2005

Kapitulli I. Dispozita dhe Parime të Përgjithshme

Neni 1.

Dispozita të Përgjithshme:

- 1.1. Mbështetur në Ligjin Nr. 8461, dt 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ndryshuar) studentët në cdo shkollë të lartë universitare zgjedhin Qeverinë Studentore (Neni 8).
- 1.2. Thirrja, organizimi dhe zhvillimi i zgjedhjes së qeverisë studentore bëhen sipas ligjit Nr. 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ndryshuar, **Neni ...)** **Udhëzimit nr....., datw.....të MASH për Qeverinë Studentore, si edhe dispozitave të kësaj Rregulloreje.**
- 1.3. Kjo Rregullore ka fuqi për zgjedhjet për Qeverinë Studentore për vitin 2004 – 2005. Pas organizimit të zgjedhjeve, qeveria studentore e zgjedhur në bazë të kësaj Rregullore, do të hartojw të gjithë bazën e funksionimit të saj sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2.

Parime të Përgjithshme:

- 2.1. Qeveria Studentore është një organizim studentor i zgjedhur nga studentët në bazë të parimeve demokratike, normave ndërkombëtare të së drejtës dhe legjislacionit shqiptar.
- 2.2. Qeveria Studentore përbëhet nga studentët e zgjedhur në bazë të kurseve dhe njësisive akademike të çdo Fakulteti.
- 2.3. Zgjedhja e studentëve bazohet në të drejtën e çdo studenti për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur.
- 2.4. Procesi zgjedhor duhet të karakterizohet nga transparenca, garantimi i së drejtës për informim të të gjithë studentëve për procesin zgjedhor, rregullat, datat, procedurat e kandidimit dhe votimit si dhe të drejtën e organizimit të fushatave elektorale të kandidatëve konkurrues.
- 2.5. Votimi kryhet i fshehtë, me fletë votimi standarde dhe në kushtet e një procesi korrekt dhe të garantuar larg manipulimit, influencimit në proces apo të ushtrimit të presionit nga kushdo autoritet i brendshëm apo i jashtëm.
- 2.5. Për të garantuar një mandat sa më përfaqësues të të zgjedhurve, ata duhet të kenë siguruar mbi 50% të votave të pjesmarrësve edhe në rast se për të arritur këtë numër duhet të zhvillohen zgjedhje me balotazh ndërkohë që, zgjedhjet të quhen të vlefshme, duhet që në to të marrin pjesë mbi 50% e studentëve që janë në listën e votuesve. Në rast se nuk plotësohet numri i nevojshëm i votuesve zgjedhjet shtyhen për një afat të dytë.

Neni 3.

Strukturat e zgjedhjes së qeverisë studentore

Strukturat e zgjedhjes së qeverisë studentore janë:

- A. Qeveria Studentore e Universitetit
- B. Pwrfaqwsia e studentwve tw fakultetit?

Kapitulli II.

Thirrja dhe Organizimi i Zgjedhjeve:

Neni 4.

- 4.1. Qeveria Studentore zgjidhet çdo vit në periudhën tetor-nëntor.
- 4.2. Kalendari zgjedhor është publik, përcaktohet që më parë dhe përgatitet duke marrë parasysh kushtet teknike të një pjesmarrje maksimale për cdo njësi zgjedhore.
- 4.3. Zgjedhjet organizohen nga Komisioni Zgjedhor Studentor i ngritur pwr kwtw qwillim, ku merr pjesw edhe njw pwrfaqwsues i Rektorit.
- 4.4. Komisioni Zgjedhor Studentor që organizon zgjedhjet në çdo universitet i cili ka për detyrë:
 - a. të thërrasë zgjedhjet për qeverinë studentore
 - b. organizimin e procesit zgjedhor
 - c. të kërkojë nga dekanatet e cdo fakulteti që të garantojnë kushtet teknike të një procesi demokratik dhe korrekt në ambientetet e fakulteteve të tyre.
- 4.5. Rektorati ka për detyrë të prodhojë të gjithë bazën materiale për procesin e votimit e cila duhet të bazohet nga disa standarde të përgjithshme.

Neni 5.

E drejta për informim dhe transparenca e procesit zgjedhor:

- 5.1. Zgjedhjet zhvillohen në bazë të parimeve demokratike të garantimit të së drejtës së votës së lirë dhe të fshehtë, të një procesi transparent, duke u bazuar në përdorimin e një liste votuesish, përdorimit të fletëvotimeve të vulosura, të numërimit të fletëvotimeve dhe të shpalljes së rezultateve në prezencë të votuesve.
- 5.2 Studentët duhet të njihen me rregullat e zgjedhjeve të cilat duhet të afishohen në cdo fakultet në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme për të gjithë.
- 5.3 . Emrat e kandidatëve duhet të afishohen në cdo fakultet në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme për të gjithë.
- 5.4. Procesi zgjedhor është i hapur dhe transparent dhe për këtë arsye kanë të drejtë të monitorojnë këtë proces nga afër organizatat rinore dhe studentore jopolitike.
- 5.5. Të gjitha organizatat rinore dhe studentore të cilat kërkojnë të monitorojnë procesin kanë të drejtë të paraqesin kërkesën e tyre duke paraqitur listën e vëzhguesve pranë Komisionit Zgjedhor Studentor që të marrin akreditimin e duhur për pjesmarrje në proces.

Neni 6

Kandidimi për Qeverinë Studentore tw Shkollws sw Lartw Universitare

- 6.1. Regjistrimi i kandidatëve kryhet pranë pikës së caktuar në nivel universitetit një javë përpara.
- 6.3. Në mënyrë që procesi të jetë sa më korrekt, duhet që të gjithë personat e interesuar të paraqesin dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre apo statusin që ata kanë në këtë proces.

Neni 7

E drejta për fushatë elektorale

- 7.1. Kandidatët kanë të drejtë të prezantojnë idetë, opinionet dhe qëndrimet e tyre përballë komunitetit studentor nëpërmjet përdorimit të ambienteve të fakultetit jashtë kohës së përdorimit akademik.
- 7.2. Për këtë arsye ata inkurajohen të organizojnë edhe forume të përbashkëta me kandidatët për të shprehur opinionet e tyre përballë komunitetit studentor.
- 7.3. Administrata e Fakultetit duhet të lejojë përdorimin e ambienteve akademike jashtë kohës kur ato përdoren për mësimdhënie si dhe përdorimin e hapësirave për vendosjen e lajmërimeve dhe materialeve promociionale për kandidatët, të cilët duhet të marrin përsipër pastrimin e ambientit pas mbylljes së fushatës elektorale.

Neni 8

Komisioni Zgjedhor për Qeverinë Studentore

- 8.1. Komisioni zgjedhor përbëhet nga Kryetari i cili është përfaqësues i Administratës së Rektoratit, 2 përfaqësues të cdo fakulteti (të parët në regjistër në grupin e parë të vitit të parë dhe që pranojnë t'a kryejnë këtë funksion dhe nuk janë kandidatë).
- 8.2. Zgjedhjet në cdo njohësi zgjedhore kryhen në rast se ndodhen 50%+1 e studentëve të regjistruar në listë.
- 8.3. Komisioni Zgjedhor pajiset nga Kryetari i Komisionit Zgjedhor me listën e votuesve (e cila është prodhuar nga Sekretaria e fakultetit bazuar në regjistrat përkatës) duke i kërkuar cdo student të vendosë firmën kundrejt marrjes në dispozicion të fletë votimit.
- 8.4. Fletëvotimet përgatiten nga Rektori dhe duhet të firmosen nga anëtarët e Komisionit Zgjedhor.
- 8.5. Komisioni Zgjedhor duhet të ndjekë mënyrën korrekte të hedhjes së fletëvotimit në kutinë e votimit dhe duhet të numërojë votat e mbledhur (duke i verifikuar që të jenë të barabarta me ato të dhëna) sapo të mbarojë procesi i votimit.
- 8.6. Votat numërohen në mënyrë të hapur direkt pas mbylljes së procesit të votimit dhe gjithkush dhe në radhë të parë kandidatët dhe vëzhguesit e jashtëm mund të vëzhgojnë procesin.
- 8.7. Në rast se fituesi nuk ka siguruar 50%+1 të votuesve të regjistruar në listë atëherë procesi përsëritet me balotazh midis 2 personave që kanë mbledhur më shumë vota.
- 8.8. Në balotazh i zgjedhuri fiton me shumicë të thjeshtë. Pas numërimit të votave shpallet fituesi dhe firmoset procesverbali nga të gjithë anëtarët e Komisionit dhe nëse duan mund të firmosin edhe kandidatët kundrejt dhe shprehjes së kundërshtimit të tyre ndaj vendimeve përkatëse nëse kanë.

Neni 11

Shpallja e Rezultatit të Zgjedhjeve për Qeverinë Studentore në nivel Fakulteti

- 11.1. Rezultati i zgjedhjeve shpallet publikisht që në njësinë përkatëse zgjedhore, në ambientet e universitetit, në mediat universitare nëse ka dhe procesverbali depozitohet në sekretarinë e Fakultetit, ndërsa secili nga personat firmosës ka të drejtë të marrë nga një kopje të procesverbalit.
- 11.2. Procesverbali firmoset edhe nga vëzhguesit e akredituar të cilët kanë të drejtë të marrin kopjen e tyre të procesverbalit.

Neni 12

Organizimi i Zgjedhjeve për Kryesinë e Qeverisë Studentore të Fakultetit

- 12.1. Pas përfundimit të zgjedhjes në nivel Fakulteti, përfaqësuesi i autorizuar i Rektoratit duhet të thërrasë të gjithë të zgjedhurit që të organizojnë një mbledhje zgjedhore për të zgjedhur Kryesinë të përbërë nga Kryetari, 2 NënKryetarë, Sekretari i Përgjithshëm.
- 12.2. Lajmërimi i të gjithëve të zgjedhurve kryhet në mënyrë publike nëpërmjet një njoftimi që vendoset në këndin e informacioneve të Fakultetit.
- 12.3. Votimi është i fshehtë dhe drejtues të Qeverisë Studentore të Fakultetit janë ata që marrin më shumë se 50% të votave.
- 12.4. Votimi është i vlefshëm kur në të marrin pjesë mbi 4/5 e të zgjedhurve në nivel Fakulteti.
- 12.5. Në fillim zgjidhet Kryetari, pastaj 2 NënKryetarët dhe më pas Sekretari i Përgjithshëm.
- 12.6. Kryetarët e Qeverive Studentore fitojnë automatikisht statusin e pjesmarrjes në Qeverinë Studentore të Universitetit.
- 12.7. Në rast se Kryetari i Qeverisë Studentore të Fakultetit heq dorë nga përfaqësia në Qeverinë Studentore në Universitetit, këtë status e fiton automatikisht nënkryetari që ka marrë më shumë vota. Në rast se edhe ky heq dorë nga përfaqësimi në Qeverinë Studentore të Universitetit këtë status e fiton NënKryetari tjetër. Në rast se edhe ky i fundit heq dorë nga përfaqësimi, atëherë anëtar bëhet Sekretari i Përgjithshëm.
- 12.8. Në këtë mbledhje përcaktohet edhe se cili do të jetë personi që do të përfaqësohet në Qeverinë Studentore të Universitetit.

Neni 13

Organizimi i Zgjedhjeve për Kryesinë e Qeverisë Studentore të Universitetit

- 13.1. Qeveria Studentore në nivel Universiteti përbëhet nga një përfaqësues për cdo Fakultet
- 13.2. Mbledhja zgjedhore për Qeverinë Studentore të Universitetit thirret nga Rektori (I cili duhet të garantojë mirëinformimin e të gjithë Kryesive të të gjithë Fakulteteve të Universitetit përkatës).
- 13.3. Qeveria Studentore e Universitetit zgjedh me vota të fshehta në fillim Kryetarin dhe pastaj Sekretarin e Përgjithshëm me shumicë të thjeshtë votash

Neni 14.

E drejta për apelim

- 14.1. Në Shkollat e Larta njihet e drejta për ankim dhe apelim, lidhur me procedurat dhe rezultatet e fushatës zgjedhore.
- 14.2. Ankimet që kanë të bëjnë me zhvillimin e fushatës zgjedhore dhe organizimin e votimeve për të gjitha nivelet, i drejtohen me shkrim Komisionit të Apelit, i cili jep përgjigje brenda tre ditëve nga data e ankimit.
- 14.3. Komisioni i Apelit ngrihet nga Rektori dhe përbëhet nga 2 përfaqësues të Rektoratit dhe 1 përfaqësues i Dekanatit.
- 14.4. Apeli mund të bëhet ndaj vendimeve që nga e drejta për kandidim dhe deri në rezultatin e votimit dhe i paraqitet me shkrim Komisionit të Apelit pranë Rektoratit brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit të votimit.
- 14.5. Komisioni i Apelit thërret për sqarim:
 - a. Në cdo rast Përfaqësuesin e Rektoratit pranë Fakultetit i cili është marrë me procedurat zgjedhore përkatëse,

- b. Përfaqësuesin e Fakultetit në rast se kemi të bëjmë me një ankesë për procedurat e kandidimit,
 - c. Anëtarët e Komisionit Zgjedhor për Qeverinë Studentore në rast se apelimi bëhet për procedurat e votimit.
 - d. Anëtarët e Komisionit Zgjedhor për Kryesinë e Qeverisë Studentore të Fakultetit në rast se kemi apelim për zgjedhjet e Kryesisë së Qeverisë Studentore të Fakultetit.
- 14.6. Në rast se ankesa ka të bëjë me procedurat zgjedhore për Kryesinë e Qeverisë Studentore të Universitetit, atëhere Komisioni I Apelit duhet të drejtohet nga vetë Rektori I Universitetit.

Neni 14.

Përfaqësimi i studentëve në organet vendimarrëse në nivel Fakulteti dhe Universiteti

- 14.1. Mbështetur në Ligjin Nr. 8461, dt 25.02.1999 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” (Ndryshuar) dhe Statutit të Universitetit Qeveria Studentore përfaqësohet në organet vendimarrëse në nivel Fakulteti dhe Universiteti në rastet kur vendet e përfaqësuesve studentor janë vakant.

Neni 15

Hyrja në fuqi

- 15.1. Kjo rregullore hyn në fuqi 1 javë pas shpalljes së saj nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.